



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Vazhdon mbledhja e fustanave dhe fundeve si kontribut për instalacionin artistik “Mendoj për ty”

Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) do të mbajnë takim të përbashkët, nesër, prej orës 11:00 – 15:00, në Hotel Grand, Pirshtinë. Në këtë takim do të marrë pjesë edhe [Presidentja e Republikës së Kosovës](#), zonja Atifete Jahjaga.

Anëtarët e Lobit dhe të Rrjetit do t'i dorëzojnë Presidentes fustanat/fundet që i kanë mbledhë për të kontribuar në instalacionin artistik “Mendoj për ty” të artistes Alketa Xhafa-Mripa, i cili i dedikohet grave që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës, organizuar nga [Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës](#), i themeluar dhe i udhëhequr nga Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga.

Ky instalacion ka për qëllim të portretizoj pafajësinë e grave të cilat kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës dhe tani kanë nevojë për mbështetjen e të gjithë shoqërisë.

Instalacioni do të realizohet duke vendosur mijëra fustane dhe funde të grave në varëse të rrobave në fushën e stadiumit të Prishtinës. Fundet dhe fustanet po mblidhen (deri me 5 qershor) në pikat e grumbullimit në të gjithë vendin me mbështetjen e organizatave jo qeveritare. Secili fund dhe fustan i dhuruar do bëhet pjesë e instalacionit.

Ky instalacion është pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit të organizuar nga Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës (për më shumë informata rreth këtij aktiviteti dhe pikave të grumbullimit kliko [këtu](#)).

[Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës \(RrGGK\)](#) është të përkrahë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anëmbanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjeti i 93 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Që nga viti 2010, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka përkrahur aktivitetet e Grupeve Avokuese të Grave (GAG) nëpër komuna të ndryshme të Kosovës. Në takimin e tretë GAG u shëndrrua në [Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë](#) dhe kësaj mundëson edhe burrave dhe djemve të Kosovës të cilët përkrahin të drejtat e barabarta mes grave dhe burrave, të jenë pjesë e Lobit.

Lobi për Barazi Gjinore, i cili përbëhet nga gra përfaqësuese të skenës politike dhe shoqërisë civile nga 24 komuna të ndryshme të Kosovës, do të vazhdojë të avokoj në nivel lokal dhe qendror për çështjet drejt arritjes së barazisë gjinore në Kosovë.

Për detaje më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni në info@womensnetwork.org apo në +381 (0)38 245 850. Facebook: [Lobi për Barazi Gjinore](#) dhe [Kosova Women's Network](#).